# Ditari i një të papuni!!

*Written by Ferdinand VELIU*
*Friday, 26 December 2014 02:25*

Like Share Be the first of your friends to like this. Share

Ferdinand VELIU

E dashur bija ime mos u trishto që këtë Krishtlindje s’të bleva dot dhuratë. Të më besosh nuk munda, sepse për herë të parë në jetën time nuk kam asnjë lek në portofol, madje nuk kam kujt t’i kërkoj borxh, sepse edhe të tjerët nuk kanë. Të shikoja për çdo ditë, kur tek kalendari i varur në kuzhinë me duart e vogla shënoje ditët, duke pritur plot gëzim që të vinin festat, eh kjo festë. Tashmë jam i papunë, sepse kështu menduan disa, dhe pse gjithmonë jam përpjekur që në profesionin tim të isha më i mirë, dhe pse mundohesha që në punën time të mos kishte asnjë mangësi.., një ditë të bukur me diell më sollën përpara një fletë ku shkruhej se isha i pushuar. Ishte kaq qesharake “Mungesë performance”, kur korridoreve të institucionit kolegët pëshpërisnin gjithmonë nën zë, se isha më i miri, megjithatë askush nuk pyeti për mua, as për familjen time, më flakën si të isha një copë leckë e vjetër e pa vlerë. Atë ditë i mblodha gjërat e mia në një kuti të vjetër kartoni, i trazuar, i trishtuar, i revoltuar, kur dola jashtë institucionit ku punoja në kazanin e parë i hodha të gjitha përveç një kornize që kishte foton tënde, duke buzëqeshur. Gjatë gjithë rrugës e shikoja buzëqeshjen tënde dhe për herë të parë atë ditë, ajo ëmbëlsi më vriste në shpirt dhe këmbët nuk më bënin që të nxitoja për tek ty. Çfarë të thosha?? Sa e sa herë vetëm vrapoja të lumturohesha kur të përqafoja, e lodhja e ditës së punës më ikte si me magji. Padrejtësisht ke hyrë edhe t’i tashmë tek problemet e mia, sepse t’i dëgjon, kupton, shikon. Këtë herë nuk ndodhi si në vitet e kaluara, kur t’i më porositje për dhuratën që të pëlqente të kishe dhe padyshim unë atë të zgjidhja. Dje erdhe tek poltrona, lehtë, më hodhe krahun e brishtë rreth qafës edhe më the; Baba këtë vit mos më bli asnjë dhuratë se nuk kam më vend te dhoma ngaqë janë shumë…!

Buzëqesha me fytyrë të qarë. Mallkova veten, mallkova qeverinë, iu luta Zotit, u përlota. Gjithmonë në një shtëpi ka vend për dhurata, sepse ato janë pjesë e lumturisë së fëmijëve. Unë e di, në kalendarin e varur në mur sot do të mungojë diçka, prandaj e shikoj se për herë të parë nuk të pëlqen ta heqësh dhe të më tregosh ditët. Bashkë kemi filluar ta urrejmë, unë më shumë.

E dashur bija ime. Kurrë se kisha menduar se një ditë do të endesha i papunë, sepse jam kujdesur shumë që kjo të mos më ndodhte, prandaj isha korrekt, punoja shumë, edhe jashtë orarit dhe pse askush s’më pagoi asnjëherë, megjithëse ma pasuronin civinë vetëm me kualifikime, që fatkeqësisht kurrë s’mu nevojitën. Sistemi që u ndërtua tani nuk i do të zotët, dhe drejtësinë ka muaj që kanë vjedhur, hipokritët, militantët, servilët, të paaftët, mediokrët. Kështu ndodh këtu, nuk fiton më merita, por politika. Nejse këto ja them vetes. Shumë herë del në televizion Kryeministri, ministrat, të cilët thonë kemi punësuar kaq dhe aq, kemi shpërndarë kaq e aq dhurata, kemi ndihmuar kaq dhe aq fëmijë, të pastrehë, invalidë, pensionistë. Ti i shikon lumturohesh, sepse kurrë nuk mendon që këta lloj monstrash të veshur shik dhe që flasin bukur të gënjejnë. Çfarë drame po ta them bija ime, ja këta bukuria e rreme më lanë sot të papunë dhe ty pa dhuratë për festë. Në bllokun tim të vogël, s’ka më shifra, plane pune, udhëtimesh, projekte, edhe ai është lodhur, sepse këto tre muaj ka qenë çdo ditë i strukur në xhepin e brendshëm, i harruar. Nuk po të shfajësohem, sepse e kam fajin vet, në atë ditë të keqe kaq shumë u gënjyem, besuam, ëndërruam dhe ngritëm padashje dhe veshëm me moral të keqen, ku ditë pas dite i doli boja, duke na u shfaqur ashtu siç ishte, e hidhur, pa ndjenja, e dhunshme.

Do të mungojnë dhuratat këtë fund viti. Sepse kështu urdhëruan, sepse kështu vendosën, për mua për ty dhe për mijëra të tjerë. Të më falësh bija ime, nëqoftëse sheh se nesër do të mungojë kalendari, ta dish, unë do ta kem hequr, ka ndalur koha, ndali atë ditë, kur u adhurua djalli, ai që si do fëmijët, nënën, babanë, gruan, atdheun, Zotin. Ai që kurrë s’mendon, ai që na vret çdo ditë dhe nuk ndjen kurrë pendim. Do të mungojnë dhuratat këtë vit me kupto, por të paktën do të kemi shpresën!!!!

VIDEO - MOMENTI I EKZEKUTIMIT TE BIZNESMENIT SANTO

KERKO LAJME

Search...

PARASHIKIMI MOTIT

TIRANA, ALBANIA
Partly Cloudy
21°
Humidity: 38%
°F | °C
8 mph
Sat Sun
15 | 28 15 | 26

SUPLEMENT NE EKSPRES.AL




ME TE LEXUARAT



Add a comment...

Also post on Facebook

Posting as **Peizazhe te Fjales** ▾ Comment

Facebook social plugin


- Vrasësi i Zodiakut që nuk u zbulua kurrë
- Atentatet që mund të ndryshonin historinë
- Përse lind nevoja për të gënjyer?
- Umberto Eko / E vërteta e vetme është ajo letrare
- Një botë pa internet
- Napoleoni përballë Uellingtonit
- Ata xheste që i japin siguri Gjermanisë

Rreth Nesh Lidhjet Kontakt Vendndodhja

Back to Top